

AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI I SHOQËRISË

“JOOO” SH.P.K.

THEMELIMI

Neni 1
Ortaku themelues

1.1 Shoqëria “**JOOO**” SH.P.K. themelohet nga Ortaket:

Z. Bruno Verneau shtetas italian, lindur më 18.03.1986 ne lindur ne Piove di Sacco dhe banues ne Padova, i Identifikuar me leternjoftimin ID nr. AY4918764 dhe me zotesi te plote per te vepruar,

Z. Gabriele Greco shtetas italian, lindur më 07.01.1985 lindur ne Padova dhe banues ne Padova, i Identifikuar me Pasaporten Nr. CA37723BL dhe me zotesi te plote per te vepruar,

EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE

Neni 2
Emërtimi

2.1 Emërtimi i shoqërisë është **“JOOO” SH.P.K.**

Neni 3
Forma ligjore

- 3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.
- 3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 4
Baza ligjore

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Aktin e Themelimit, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore.

Neni 5
Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1 Veprimtaria e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj në Qëndrën Kombëtare të Biznesit (“QKB”).
- 5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është i pacaktuar.

Neni 6
Selia

- 6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Rezidencia Alba ne rrugen “Ndre Mjeda” ne kati i trete, shkalla 1, Kulla Veriore, Apartamenti 231, Tirane
- 6.2 Shoqëria mund të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësimi si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.
- 6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare që ekzistojnë ose do të krijojen në të ardhmen.

Neni 7
Emblema. Vula

- 7.1 Shoqëria do të ketë emblemën dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.
- 7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjisacionit shqiptar.
- 7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përbajnë emblemën dhe vulën e saj.

Neni 8
Objekti

- 8.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është:
 - Pergatitja dhe mirembajtja e faqeve te internetit
 - Ofrimi domain-esh, sherbimin e web hosting
 - Ofrimi sherbimeve te telekomunikacionit
 - Pergatitja dhe mirembajtja e rrjeteve sociale ne internet si dhe marketingu online
 - Shoqeria do te kryeje pa kufizim çdo aktivitet tjeter te lejueshem nga legjisacioni ne fuqi

8.1.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblese se Ortakeve.

Neni 9 Kapitali

- 9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000 ALL (Dhjete mijë ALL).
- 9.2 Pjesëmarja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
 1. Ortaku themelues Z. Bruno Verneau: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 5000 ALL që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 2. Ortaku themelues Z. Gabriele Greco: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 5000 ALL (pese mijë ALL) që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)
- 9.3 Kapitali është shlyer tërësisht.

Neni 10 Transferimi i pjesëve të kapitalit. Kufizimet.

- 10.1 Pjesët e kapitalit mund të transferohen tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” me amendimet perkatese.
- 10.2 Vendosja e çfarëdolloj barre mbi pjesët e kapitalit në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Asamblese se Ortakeve.

Neni 11 Rritja e kapitalit

- 11.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Asamblese se Ortakeve.
- 11.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të tjera të kapitalit nga ortakë të rindërtuar. Ortakët e rindërtuar pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Asamblese se Ortakeve.

Neni 12 Zvogëlimi i kapitalit

- 12.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet sipas proçedurave të parashikuara nga legjislacioni tregtar.
- 12.2 Propozimi i zvogëlimit do t'i paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar dhe administratorit të paktën 45 ditë përpara marrjes së vendimit nga Asambleja e Ortakeve te shoqërisë. Eksperti kontabël dhe administratori do të shqyrtojnë propozimin dhe do t'i paraqesin Asamblese se Ortakeve raportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.
- 12.3 Raporti i zvogëlimit të kapitalit do të miratohet me vendim të Asamblese se Ortakeve te shoqërisë.

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 13 Vendimet e Asamblese se Ortakeve

13.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë merren nga Asambleja e Ortakeve.

13.2 Vendimet e **Asamblese se Ortakeve** përfshijnë kryesisht:

- Ndryshimin e selisë ose të emërtimit të shoqërisë;
- Rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
- Shitjen ose transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar palëve të treta;
- Prishjen dhe likuidimin e shoqërisë;
- Emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë;
- Emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar, në qoftë se është e nevojshme;
- Miratimin e bilancit të shoqërisë;
- Transformimin e shoqërisë në formë të tjera.

Neni 14 Administrimi

14.1 Administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator ose një grup administratorësh që caktohen me vendim të Asamblese se Ortakeve.

14.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe drejtojë punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me udhëzimet e Asamblese se Ortakeve.

14.3 Administratori te shoqërisë jane:

Z. Bruno Verneau shtetas italian, lindur më 18.03.1986 ne lindur ne Piove di Sacco dhe banues ne Padova, i Identifikuar me leternjoftimin ID nr. AY4918764 dhe me zotesi te plote per te vepruar,

Z. Gabriele Greco shtetas italian, lindur më 07.01.1985 lindur ne Padova dhe banues ne Padova, i Identifikuar me Pasaporten Nr. CA37723BL dhe me zotesi te plote per te vepruar,

- 14.4 Administratori është përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:
- Drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
 - Përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët personalisht ose me përfaqësim;
 - Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit;
 - Përgatitjen e dokumentave në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zoteron;
 - Të zhvillojë veprimtari të tjera të çdo lloj natyre për të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektit të saj.
 - Administratori ka të drejtë për ta përfaqësuar shoqerinë në Shqipëri tek palët e treta, insitucionet apo entitetet publike ose private,
 - Të lidhë, për dhe në emër të shoqërisë kontrata me palë të treta;
 - Të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër që konsiderohet i nevojshëm për mbarëvajtjen e biznesit;
 - Të përfaqësojë shoqerinë në Shqipëri përpëra bankave të nivelit të dytë dhe Bankes së Shqipërisë si dhe të kryej, në emër të shoqërisë cdo transaksion bankar në emër të shoqërisë,
 - Të ndërmarrë çdo veprimtari tjetër ose biznes ose aktivitet, te hape dege ose zyre perfaqësimi, qe konsiderohen te nevojshëm për biznesin e shoqërisë.
- 14.5 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm për pesë vjet me të drejtë ripërtëritje ose deri në çastin e revokimit të tij me vendim të Asamblese se Ortakeve.

Neni 15 Viti financiar

- 15.1 Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të cdo viti.
- 15.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i shoqërisë do të fillojë nga ditë e regjistrimit të shoqërisë në Zyrën e Tatim Taksave dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

Neni 16 Bilanci. Kontabiliteti.

- 16.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Asambleja e Ortakeve dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.

- 16.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave të legjislacionit përkatës. Për operacione të veçanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të veçanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.
- 16.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Asamblese se Ortakeve.

Neni 17
Te Ardhurat. Dividendi

- 17.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezervë për realizimin e qëllimeve të biznesit të saj në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
- 17.2 Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së cdo ushtrimori, pas pagimit të tatimeve, mund të ndahen ndërmjet ortakëve në raport më pjesët që ata zoterojnë në kapitalin e shoqërisë.
- 17.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe çdo ortak do të pergjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e ushtrimorit të parë deri në tre ushtrimorët vijues.

Neni 18
Likuidimi

- 18.1 Prishja e shoqërisë vendoset me vendimin e Asamblese se Ortakeve.
- 18.2 Me vendimin e Asamblese se Ortakeve caktohet një likuidator ose një grup likuidatorësh që do të plotësojnë procedurat e likuidimit.
- 18.3 Likuidatori do të përgatisë raportin e likuidimit mbi gjëndjen ekonomike të shoqërisë, rreth operacioneve të mëtejshme të likuidimit dhe kohën që nevojitet përfundimin e tij. Në përfundim të kësaj procedure, Asambleja e Ortakeve do të shqyrtojë bilancin përfundimtar dhe do të miratojë përfundimin e procedurave të likuidimit.


Neni 19
Mosmarrëveshjet

- 19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtronen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

Tiranë, datë 28.02.2019

ORTAKET:

Z. Bruno Verneau



Z. Gabriele Greco

